



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
REKTORI

Nr. 1078 Prot.

Tiranë, më 09/09 /2024

**URDHËR**

Nr. 39, datë 09.09.2024

**PËR**

**“SHPALLJEN E FILLIMIT TË PROCESIT ZGJEDHOR DHE DATËN E ZHVILLIMIT  
TË ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET DHE ORGANET DREJTUESE NË  
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Mbështetur në nenin 131 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit, nr. 101, datë 13.03.2024 “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet publike të arsimit të lartë”; nenin 5, pika 3 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet, organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, miratuar nga Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, me Vendimin nr. 36, datë 29.03.2024,

**URDHËROJ:**

1. Shpalljen e fillimit të procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, në datën 21.05.2024.
2. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë është data 21.06.2024.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri njësitë kryesore të UMT-së, Komisioni i Apelimit, Komisioni Institucional Zgjedhor në UMT dhe Administratori i UMT-së.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.

